



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01.Nr. 16-4838/2016
Kaçanik, 15.02.2016

Në bazë të nenit, 5 lidhur me nenet, 12.1, 12.2(c), 40.2(a, g) dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 34.5. të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(f) të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 15.02.2016, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RREGULLORES Nr.01/2016
PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE, GJOBAVE DHE
SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

1. Me këtë Vendim, APROVOHET, Rregullorja Nr.01/2016, më tekstin e mëtejshëm (Rregullorja për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale).
2. Në rregullore është përcaktuar lartësia e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe subjekteve afariste – biznesit në territorin e komunës.
3. Rregullorja është hartuar nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Drejtoritë tjera Komunale, është përmbledhur në 31 nene, me numër të protokolit 01.Nr. 16-4838/2016 dhe e njëjta është pjesë përbërse e këtij Vendimi.
4. Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të MAPL-së si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe në Faqen Zyrtare të Komunës së Kaçanikut.
5. Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja 01-Nr. 16-3317/15 Për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale e datës 30.01.2015.
6. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesën : Kryetari i Komunës dhe të gjitha drejtoritë komunale.

Rregullorja iu dërgohet: MAPL, Kryetarit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi